

BËHU PJESË E GARËS SË OSBE-SË PËR VIDEO: FITO KONTRATË PREJ 5,500.00 EURO!



Merr pjesë në garën e Misionit të OSBE-së në Kosovë për video dhe shfrytëzo rastin për të realizuar një dokumentar të shkurtër për punën e Misionit në vlerë prej 5,500 eurosh.

Për të marrë pjesë në garë, duhet të dorëzoni një kopje të dokumentarit tuaj më të mirë të shkurtër (vetëm një dokumentar) në CD si VLC fajll në zyrën më të afërt të Misionit të OSBE-së në Kosovë deri me 5 nëntor 2010 ora 17:30. Së bashku me CD-në duhet të dorëzoni edhe CV-në tuaj dhe informatat kontaktuese. Zarin duhet ta adresoni “Gara e OSBE-së për Video”.

Për garë mund të konkurrojnë të gjithë banorët e Kosovës, film-bërës të pavarur nga mosha 18 deri në 35, me përvojë në të kaluarën në realizimin e dokumentarëve të shkurtër, dhe me qasje në pajisje përfshirë kamerë HD, pajisje për zërim dhe pajisje ndriçuese, si dhe studio e software për montazh.

Dokumentari i shkurtër do të shfrytëzohet për të promovuar të drejtat e njeriut, qeverisjen e mirë dhe çështjet e sigurisë në Kosovë, sidomos në mesin e të rinjve.

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Misionin e OSBE-së në Kosovë, zyra për informim publik në adresën elektronike press.omik@osce.org ose në numrin e telefonit 038 240 100, lokali 1449.

KJO GARË ËSHTË MUNDËSUAR NGA MISIONI I SHBA-VE NË OSBE.



Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo